

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

KËSHILLIT TË FAKULTETIT

Këshilli i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Prishtinë, me vendimin nr 818/06-2, të datës 13.12.2006, formoi Komisionin vlerësues në përbërje:

1. Dr.sc. Myzafere Limani, prof. asc., FIEK, UP – kryetare
2. Dr.sc. Jahja Kokaj, prof. ord., Kuwait University, Kuwait – anëtar
3. Dr.sc. Abdurrahman Grapci, prof.ord., FIEK, UP – anëtar

për përpilimin e raportit për zgjedhjen e një mësimdhënësi në lëndët: “*Mikroelektronikë*” dhe “*Optoelektronikë*”.

Komisioni recensues, pasi shikoi materialin e konkursit, Këshillit të Fakultetit i paraqet këtë:

RAPORT

Universiteti i Prishtinës, në gazetën “Koha ditore” të datës 16.11.2006, ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët “*Mikroelektronikë*” dhe “*Optoelektronikë*”. Në konkurs është paraqitur vetëm kandidati Dr.sc. Nebi Caka, profesor asistent.

I. Shënimet personale

Nebi Caka ka lindur më 01.03.1946 në Prishtinë, ku jeton edhe tash. Shkollën fillore dhe gjimnazin e ka kryer në vendlindje. Është diplomuar, më 1971, në Fakultetin e Elektroteknikës në Banjallukë (Universiteti i Sarajevës), në drejtimin *Elektronikë dhe Telekomunikacion* dhe, më 1979, në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, në degën *Gjuhë dhe Letërsi Shqipe*.

Studimet pasuniversitare të magjistraturës shkencore nga lëmi i *Shkencave Filologjike* i ka mbaruar, më 1985, në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, kurse ato nga lëmi i *Shkencave Teknike*, drejtimi *Elektronikë Profesionale dhe Radiokomunikime* në Fakultetin e Elektroteknikës në Zagreb, më 1988.

Më 03.09.2001 ka mbrojtur me sukses disertacionin e doktoratës, me titull “*Zbatimi i procesimit optik të të dhënave për imazhimin dhe matjen e dukurive dinamike biomjekësore*”, në Fakultetin e Elektroteknikës në Prishtinë, dhe ka fituar shkallën shkencore *Doktor i shkencave teknike*.

2. Përvoja profesionale

Pas diplomimit në Fakultetin e Elektroteknikës, Nebi Caka ka punuar një kohë të shkurtër si inxhinier i automatikës dhe rregullimit në Kombinatin Elektroenergjetik "Kosova" në Obiliq, e pastaj si profesor dhe zëvendës drejtor në Qendrën Shkollore Teknike "19 Nëntori" në Prishtinë. Më 1973 është punësuar në Televizionin e Prishtinës, ku ka punuar si kryeinxhinier i Sektorit të Mirëmbajtjes deri më 5 korrik të vitit 1990, kur është pushuar, me dhunë, nga puna, së bashku me 1300 punëtorë të tjerë shqiptarë të Radiotelevizionit të Prishtinës. Nga viti 1990 e deri në vitin 1992 ka punuar si inxhinier i mirëmbajtjes në firmën "ARC Electronics" në Prishtinë, e në vitin 1992 ka kaluar në punë të rregullt në Fakultetin e Elektroteknikës në Prishtinë, ku punon edhe tash. Aktualisht është i angazhuar si ekspert edhe në firmën GMDS Sh.p.k., në Prishtinë, ku është përgjegjës për buqetën satelitore AlbanicaSat.

Si inxhinier i Televizionit të Prishtinës, Nebi Caka ka qenë disa herë për përsosje profesionale, nga lëmi i televizionit dhe elektronikës profesionale, në kurse e trajnime të certifikuara, te firmat e njohura *Markoni, Ampex, RCA, Schlumberger, Sony, Bosch, Agfa-Geavert* dhe *Kudelski* – në Angli, Francë, Gjermani, Itali, Belgjikë e Zvicër. Kohët e fundit ka ndjekur disa kurse nga metodika e mësimdhënies, përpilimi i kurrikulave mësimore dhe përpilimi i strategjive dhe planeve të zhvillimit. E flet dhe e shkruan, përveç shqipes (gjuhë amtare), edhe anglishten e serbokroatishten e mund ta shfrytëzojë edhe literaturën profesionale në frëngjisht e italisht.

2.1 Kurset dhe trajnimet profesionale e pedagogjike

1. Trajnimi "*Identifikimi i masave, projekteve e programeve dhe formimi i buxheteve*", Instituti Riinvest dhe SPZHK (Strategjia dhe Plani Zhvillimor i Kosovës), Prishtinë, qershor 2006.
2. Trajnimi "*Nga SWOT-i në vizion, objektivat dhe politikat prioritare*", Instituti Riinvest dhe SPZHK, Prishtinë, maj 2006.
3. Trajnimi për "*Aspektet metodologjike të planifikimit në BE dhe analiza e gjendjes ekzistuese*", Instituti Riinvest dhe SPZHK, Prishtinë, prill 2006.
4. Trajnimi për *Sistemin e kriptimit Irdeto M-Crypt*, Irdeto Access, Hoofddorp, Holandë, korrik 2003.
5. *Programi i trajnimit për Vlerësim në arsimin e lartë* – Qendra për arsim e Kosovës – Kosova Education Center (KEC), Prishtinë, qershor 2003.
6. *Programi i trajnimit të mësimdhënësve universitarë "Zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit"* i Shoqatës Ndërkombëtare të Leximit dhe Shkrimit – The International Reading Association, Washington D.C. (SHBA), Ohër, Maqedoni (21-26.11.2002) & Durrës, Shqipëri (02-05.04.2003).
7. *Vizitë studimore për administratorët e lartë të Universitetit të Prishtinës* në Universitetin e Evropës Qendrore (Central Europe University), Budapest, Hungari, 20-27 nëntor 1999.
8. *Provimi profesional* (Nr. 152-2-89/91), Prishtinë, shkurt 1991.
9. *Kursi për Konceptet e videos digjitale*, AMPEX Corporation (SHBA), Reading, Angli, tetor 1985.
10. *Kursi për Konceptet e Formatit C*, AMPEX Corporation (SHBA), Reading, Angli, shtator 1985.
11. *Kursi për Videomikserët e studios (4100)*, AMPEX Corporation (SHBA), Milano, Itali, prill 1984.
12. *Kursi për Videorekorderët e studios (VPR-80)*, AMPEX Corporation (SHBA), Milano, Itali, janar 1984.

13. *Kursi për Kamerat e studios (KCP 60)*, BOSCH GMBH, Darmstadt, Gjermani, tetor 1981.
14. *Kursi për Karakter-gjeneratorët (Chyron IV)*, AMPEX Corporation (SHBA), European Training Centre, Milano, Itali, dhjetor 1980.
15. *Kursi për Audioteknikën profesionale*, Computers Schlumberger, Département Audio Professionnel, Ruel-Mailmaison, Francë, 05.02.1976-05.03.1976.
16. *Kurset teorike dhe praktike për Mirëmbajtjen e magnetofonave profesionale NAGRA IV dhe 4.2*, Kudelski S.A., Cheseaux, Lausanne, Zvicër, shkurt 1975.
17. *Kursi i anglishtes*, International Language Center, Londër, Angli, 24.09.1973-14.12.1973.

2.2 Anëtarësimet dhe angazhimet profesionale

- Anëtar i Forumit të studiuesve shqiptarë Alb-Shkenca.org
- Anëtar i Institutit Alb-Shkenca
- Anëtar i Njësisë Operative për Mësim Elektronik për Kosovë (*eLearning Task Force for Kosova – eLTFK*)
- Anëtar i Shoqatës së Inxhinierëve dhe Teknikëve të Elektroteknikës të Kosovës
- Anëtar i Komisionit për çështje të shqipes standarde, pranë Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës
- Anëtar i Komisionit për transkriptimin e fjalëve dhe të emrave të huaj në gjuhën shqipe, pranë Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës
- Anëtar i Grupit për hartimin e platformës së Enciklopedisë shqiptare, pranë Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës

3. Aktiviteti pedagogjik

Nebi Caka është angazhuar në mbajtjen e ushtrimeve në Katedrën e Elektronikës me Telekomunikacion në Fakultetin e Elektroteknikës të Prishtinës që nga viti 1976, në fillim si bashkëpunëtor i jashtëm e pastaj si asistent. Gjatë kësaj kohe ka mbajtur ushtrimet nga lëndët: *Elektronika I, Elektronika II, Televizioni* dhe i janë besuar ligjëratat edhe nga lënda *Programi konstruktiv*.

Nga viti 1992 punon si mësimdhënës i rregullt në Fakultetin e Elektroteknikës (tash: Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike) në Prishtinë, ku ligjëron lëndët *Mikroelektronikë, Optoelektronikë dhe Projektimi i qarqeve elektronike me kompjuter (CAD në elektronikë)*. Mban ligjëratat edhe nga *Sistemet e komunikimeve optike* për studentët në studimet për master.

Ka mbajtur ligjëratat edhe nga lëndët: *Elektronika e avancuar dhe Sistemet e komunikimeve satelitore* në studimet për magjistraturë shkencore, po në këtë fakultet.

Në periudhën 1999-2004 ka mbajtur ligjëratat, si profesor vizitor, nga lëndët *Bazat e elektronikës dhe Elektronika impulsive e digjitale* në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në Universitetin e Tetovës, në Tetovë.

Tash është i angazhuar edhe në Fakultetin e Shkencave Teknike të Aplikuara në Mitrovicë (Universiteti i Prishtinës) për lëndët *Mikroelektronikë dhe Arkitektura dhe organizimi i kompjuterëve*.

Në vitet 1997-2001 ka qenë prodekan për mësim i Fakultetit të Elektroteknikës në Prishtinë e para kësaj, një kohë të shkurtër, edhe shef i Katedrës së Elektronikës.

4. Aktiviteti shkencor dhe publikimet e tjera

4.1 Publikimet shkencore

1. **Nebi Caka**, Milaim Zabeli, Myzafere Limani, Qamil Kabashi, "Influence of MOSFET parameters on its parasitic capacitances and their impact in digital circuits", *WSEAS Transactions on Circuits and Systems*, 2007 [pranuar për botim].
 - Zhvillimi i avancuar i proceseve teknologjike ka ndikuar në përdorimin e gjerë të transistorëve MOSFET për projektimin e qarqeve të integruara digjitale me shkallë të lartë të paketimit-integritimit (VLSI). Por, në transistorët MOSFET janë të pranishme kapacitetet parazitare, të cilat ndikojnë në shpejtësinë e punës së qarqeve dhe në disipimin (lirimin) e fuqisë. Qëllimi i këtij punimi është të rishikojë ndikimin e përmasave të kanalit dhe të zonës së sorsit (burimit) e të drejnit (derdhjes), të përqendrimeve të papastërtive në nënshtresë dhe në zonat e drejnit, të sorsit e të pjesëve anësore, si dhe ndikimin e nivelit të polarizimit në vlerat përkatëse të kapaciteteve parazitare. Bazuar në rezultatet e përftuara, do të ndërmerren masat përkatëse për minimizimin e kapaciteteve parazitare që rezultojnë në një shpejtësi më të madhe të punës dhe në një disipim më të vogël të fuqisë në kushte dinamike. Zvogëlimi i përmasave të zonave të përmendura më lart varet nga mundësitë e procesit teknologjik për përmasat minimale.
2. **Nebi Caka**, Milaim Zabeli, Myzafere Limani, Qamil Kabashi, "Impact of MOSFET parameters on its parasitic capacitances", *WSEAS Conference EHAC '07*, Corfu Island, Greece, February 16-19, 2007 [pranuar për botim].
 - Ky punim ka për qëllim llogaritjen e kapaciteteve parazitare të MOSFET-it, dhe pastaj, bazuar në to vështrohet ndikimi i parametrave fizikë të MOSFET-it në këto kapacitete parazitare. Këto kapacitete kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shpejtësinë e punës së qarqeve me MOSFET-a. Që të rritet shpejtësia e punës së këtyre qarqeve, duhen zvogëluar kapacitetet parazitare në vlerën më të vogël të mundshme që lejon procesin teknologjik. Në punim është analizuar efekti i kapacitetit të gejtit (portës) dhe i kapaciteteve të bashkimit në varësi nga përmasat e MOSFET-it.
3. **Nebi Caka**, Jahja Kokaj, "The use of the fluorescence intensity for a computer controlled lithotripter", *Kërkime* 14, ASHAK, 2006 [në botim].
 - Në këtë punim propozohet një litotriptor laserik i kontrolluar me kompjuter. Puna e tij bazohet në korrelacionin e sinjaleve të përftuara nga imazhet balistike dhe fluoreshente (jolineare). Imazhet fluoreshente të gurëve të fshikëzës së tëmthit, të tëmthit dhe të indeve fotografohen me anë të një kamere shpejtësilartë (strik-kamere), dhe regjistrohen në domenin frekuencor dhe në domenin kohor. Për korrelacion përdoren sinjalet njëdimensionale të varura nga koha dhe imazhet balistike të përftuara më herët. Fuzionimi i këtyre sinjaleve të korrelacionit mundëson një litotripsi laserike më të besueshme. Kemi një dallim më të qartë ndërmjet gurit si shënjestër dhe fshikëzës së tëmthit e indeve përreth.
4. Jahja Kokaj, **Nebi Caka**, "Laser lithotripsy using fluorescent spectroscopy" *ANASH – Approaching Science*, ISBN: 0101062006, Viti I, Nr. 1, Qershor 2006, f. 51-53.
 - Në këtë punim është paraqitur studimi i spektroskopisë laserike në gurët dhe indet e fshikëzës së tëmthit (idhcës). Spektrat fluoreshentë të gurëve, të tëmthit (vverit) dhe të indeve të fshikëzës së tëmthit të njeriut janë regjistruar me anë të një strik-kamere në domenin frekuencor dhe kohor. Në bazë të rezultateve të përftuara është vlerësuar potenciali i metodës së fluoreshencës si mjet diagnostikimi për të bërë dallimin ndërmjet gurëve të idhcës dhe indeve të saj.
5. **Nebi Caka**, Blerim Rexha, Xhavit Hadergjonaj, "Shërbimet me vlerë të lartë të shtuar", Instituti "Riinvest", 2006.

- Shërbimet me vlerë të lartë të shtuar (*High Value-Added Services*) janë shërbime të cilat përdorin teknologjinë e informacionit dhe komunikimeve (TIK) për t'ua shtuar vlerën shërbimeve bazë. Ato mundësojnë një zgjerim të qëndrueshëm të biznesit dhe rritjen e profitit dhe të efikasitetit, dhe janë sfida për të gjithë sektorët në një shoqëri. Ato në radhë të parë bazohen në të ashtuquajtura shërbime elektronike apo e-shërbime (*e-services*), siç janë: gatishmëria elektronike, arsimimi elektronik, qeverisja elektronike, biznesi elektronik dhe shëndetësia elektronike. Në këtë punim është përvijuar strategjia dhe plani zhvillimor në këtë veprimtari ndërsektoriale në Kosovë për periudhën 2007-2013, me theks në përmirësimin e cilësisë së arsimimit dhe të infrastrukturës në Kosovë, si kusht të domosdoshëm për të ofruar e-shërbime adekuate, përkatësisht për të rritur kualitetin e e-shërbimeve.
6. **N. Caka**, M. Shena, G. Jashari, “Analiza dhe diskutimi i hipotezës së Plankut”, *Acta Chimica Kosovica*, 14(1) 97/104 (2005), Prishtinë 2005.
 - Sipas hipotezës së Plankut, procesi i emetimit dhe përthithjes së energjisë së rrezatimit realizohet me porcione minimale të energjisë apo me kuante, të cilat janë në përpjesëtim me frekuencën e rrezatimit ($E = h\nu$). Hipoteza e Plankut jo vetëm që revizionoi përfytyrimet klasike, por vetëm gjatë dhjetëvjeçarit të parë të ekzistencës së vet zgjidhi tri probleme fundamentale që nuk mund t'i zgjidhte fizika klasike: sqarimi i rrezatimit të trupit të zi, fotoefekti dhe problemi i qëndrueshmërisë së atomit. Me të lindi fizika kuantike. Pikërisht një retrospektivë mbi paraqitjen, zhvillimin dhe pikëpamjet e sotme mbi kuantet paraqet edhe objektivin e këtij punimi.
 7. Myzafere Limani, **Nebi Caka**, Milaim Zabeli, “Llogaritja e tensionit të pragut në transistorët NMOS me kanal (të gjatë) të induktuar dhe ndikimi i tensionit polarizues ndërmjet soursit dhe nënshtresës (trupit)”, *Kërkime* 13, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2005.
 - Në punim analizohen parametrat fizikë sipas të cilëve përcaktohet vlera e tensionit të pragut të përcimit të transistorëve **NMOS**. Tensioni i pragut i këtyre transistorëve është i përcaktuar nga procesi teknologjik i ndërtimit të tyre. Duke ndryshuar parametrat fizikë mund të arrihet deri tek vlera e nevojshme e pragut. Përmes një programi të shkruar në gjuhën programuese në C++, në bazë të parametrave fizikë të dhënë hyrës, mund të llogaritet vlera e tensionit të pragut si dhe ndikimi i tensionit të polarizimit ndërmjet soursit dhe drejnit.
 8. **Nebi Caka**, “Modelet dhe metodologjitë e mësimit elektronik”, *Seminar për mësimin elektronik*, eLTF Kosova, Austrian Cooperation, WUS Austria, Prishtinë, 21 prill 2005.
 - Me mësim elektronik (e-mësim) nënkuptohet përdorimi i medieve elektronike, siç janë interneti, intraneti e ekstraneti, CD-ROM-i e DVD-ja, audioshiritat dhe videoshiritat, televizioni satelitor e televizioni interaktiv (ndërveprues), telefoni celular (mobil) etj. – për të krijuar, nxitur, mbajtur dhe lehtësuar mësimin, formal ose joformal, në sektorin publik ose në sektorin privat, në çdo kohë dhe në çdo vend. Në këtë punim janë paraqitur metodat dhe metodologjitë e sprovuara të mësimit elektronik dhe janë analizuar veçoritë e tyre.
 9. **Nebi Caka**, *Terminologjia e informatikës në gjuhën shqipe dhe standardizimi i saj në fjalorë*, Konferenca “Leksikografia shqipe – Trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 3 dhjetor 2004.
 - Numri i termave të krijuar për të shprehur konceptet e reja që kanë të bëjnë me informatikën dhe me teknologjinë e informacionit vazhdimisht rritet, meqë vazhdimisht rritet numri i pajisjeve të reja të teknologjisë së informacionit e i programeve kompjuterike. Këto pajisje e këto programe kryesisht vijnë nga SHBA-ja, e bashkë me to dokumentacioni përcjellës me termat përkatës në gjuhën angleze. Si rrjedhojë vendet joanglishtfolëse ballafaqohen me çështjen e përkthimit, në gjuhë vendi, të dokumentacionit dhe të termave që i shoqërojnë

këto pajisje dhe këto programe, shpesh menjëherë pas hedhjes së tyre në treg. Kjo kërkon nga përkthyesit dhe nga terminologët e këtyre vendeve analizimin e termit burimor dhe gjetjen e barasvlerësit të saktë në gjuhën e tyre. Mungesa e një terminologjie të njësuar (që shihet nga krahasimi i disa fjalorëve anglisht-shqip) pa mëdyshje e vështirëson përdorimin e efektshëm të pajisjeve dhe të programeve kompjuterike nga ana e joprofesionistëve, po edhe nga ana e vet profesionistëve. Së këtëjmi del edhe nevoja e ngutshme për standardizimin e terminologjisë së informatikës, së paku të asaj pjese që tashmë ka hyrë në përdorim të gjerë, jo vetëm profesional, por edhe të përgjithshëm.

10. **Nebi Caka**, “Zhvillimi i burimeve njerëzore në Kosovë në lëmin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimeve (TIK)” *Konferenca e katërt ndërkombëtare e IEME-së*, Prishtinë, 7-8 maj 2004.
 - Në punim përshkruhet gjendja e tanishme jo e kënaqshme në sektorët e ndryshëm (arsim, shërbime publike, shëndetësi etj.) për sa u përket burimeve njerëzore në lëmin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve (TIK) dhe ç’duhet bërë që kjo gjendje të ndryshojë për të mirë. Qëllimi i strategjisë për TIK, për sa u përket burimeve njerëzore duhet të jetë: ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore të mjaftueshme dhe kompetente për përdorimin e produkteve të TIK-ut dhe për krijimin e produkteve të TIK-ut, të cilat do të jenë të afta t’u përgjigjen kërkesave gjithnjë më të mëdha të së sotmes dhe të së nesërmes në fushën e TIK-ut dhe të cilat do të jenë forcë shtyisë për një zhvillim ekonomik dhe shoqëror të qëndrueshëm të Kosovës.
11. **Nebi Caka**, Shkelzen Cakaj, “Kahet e zhvillimit të sistemeve transmetuese në sistemin e telekomunikacionit të Kosovë”, Konferenca Shkencore “*Zhvillimi i qëndrueshëm tekniko-teknologjik dhe mjedisi*” (Përmbledhje punimesh), ISBN 9951-85-14-0-1, Shoqata e inxhinierëve të Kosovës, f. 261-268, Prishtinë, 2002.
 - Në këtë punim jepen kahet e zhvillimit të sistemeve transmetuese në sistemin e telekomunikacionit në Kosovë, me një retrospektivë të shkurtër të gjendjes së tij para luftës së fundit dhe me përshkrimin e dëmeve që i janë shkaktuar nga kjo luftë. Trendet zhvillimore të telekomunikacioneve në botë janë të atilla që implementimi i shërbimeve të reja, GSM, Interneti (trafiku i të cilit ka një rritje eksponenciale), shërbimet e integruara brezgjërë (*broadband*), shërbimet e transmetimit pa tela (*wireless*) të zërit dhe të të dhënave, si dhe zbatimet e tjera multimediale, kërkojnë kapacitete të gjera transmetimi, ndaj në të ardhmen, jo të largët, kapacitete që ofron teknologjia mikrovalore do të jenë të pamjaftueshme. Autorët parashikojnë implementimin e “unazës optike” (rrjetit unazor me kablllo me fije optike) për ndërlidhjen e qyteteve të Kosovës, si strukturë bazë e transmetimit për sistemin e telekomunikacionit të Kosovës në të ardhmen.
12. J. Kokaj, M. Mathew, **N. Caka**, “Microscopy of phenomena akin to laser lithotripsy”, 19th Congress of the International Commission for Optics (ICO), “*Optics for the Quality of Life*”, Firenze, Italy, 25-30 August 2002.
 - Një mikroskop i jokonvencionale është zbatuar për të vizualizuar (paraqitur) dhe për të matur fenomenet gjatë shkatërrimit të gurëve me anë të litotripsisë laserike. Duke përdorur teknikën mikroskopike ultra të shpejtë dhe metodën e fotografimit të hijes, të njohur si shadografi, janë studiuar disa fenomene të ngjashme me litotripsinë laserike. Është treguar se pozita e fijos optike, që bart rrezet laserike për thyerjen e gurit, luan një rol kyç gjatë litotripsisë laserike.
13. **Nebi Caka**, “Zbatimi i procesimit optik të të dhënave për imazhimin dhe matjen e dukurive dinamike biomjekësore” (Disertacion i doktoratës), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Elektroteknikës, Prishtinë, 2001.
 - Disertacion i doktoratës: Në këtë disertacion propozohet një metodë origjinale e zbatimit të korrelatorit optik në njohjen e gurëve dhe diskriminimin e indeve

gjatë shkrepjes së impulsit të fuqishëm laserik. Kjo metodë bazohet në sinkronizimin e impulsit pik të përftuar nga fuzionimi i korrelacionit optik të përftuar nga imazhet balistike dhe imazhet fluoreshente me impulsin e laserit (Ho-YAG) për thyerjen e gurit. Këtu propozohet po ashtu një metodë origjinale për simulimin e proceseve dinamike të plasjes së fshikëzës së fluidit të krijuar gjatë procesit të litotripsisë laserike, si pasojë e valëve goditëse, dhe përcaktimit të pikëplasjes së saj. Simulimet bëhen në mënyrë digjitale, por meqë programet përbëhen nga transformimet Furie, ato janë të përshtatshme për implementime optike. Në bazë të rezultateve të fituara me anë të algoritmeve morfologjike origjinale për përpunimin e imazheve, në bazë të kontureve të përfuara përcaktohet pozita në të cilën do të pëlçasë fshikëza e fluidit. Rezultatet e fituara me mikroskop elektronik konfirmojnë një gjë të tillë. Programet në fjalë mund të zbatohen edhe gjetiu, meqë formimi i kontureve apo skajeve në këtë mënyrë ka përparësi në krahasim me përpunimin e imazheve apo konturimeve që bëhen me algoritmet ekzistuese, siç është metoda Sobel etj. (144 faqe)

14. **Nebi Caka**, “Gjendja në Sektorin e Telekomunikacionit në Kosovë dhe kahet e zhvillimit të tij”, Konferenca ndërkombëtare *Rindërtimi i Kosovës pas luftës (Strategjia dhe Politikat)*, Prishtinë, 2000; Përmbledhje punimesh, shkurt 2001, ff. 147-159.
 - Përmbledhje nga një analizë më e gjerë dhe gjithëpërfshirëse (referuar në Konferencën ndërkombëtare *Rindërtimi i Kosovës pas luftës – Strategjia dhe Politikat*, Prishtinë, 2000) e gjendjes ekzistuese të sistemit të telekomunikacionit (centralet telefonike dhe sistemet transmetuese) në Kosovë, me një pasqyrë të strukturës së të punësuarve, të strukturës së pajisjeve dhe të objekteve që janë në shfrytëzim, si dhe me një pasqyrë dhe analizë të dëmeve të shkaktuara nga lufta, të përpjekjeve dhe investimeve të bëra për rehabilitimin e këtij sistemi, dhe të planifikimit afatshkurtër dhe afatmesëm të zhvillimit të telefonisë fikse dhe të telefonisë mobile në Kosovë.
15. **Nebi Caka**, “The situation of Telecommunication Sector in Kosova and Courses of its Development”, International conference “*Post-War Reconstruction of Kosova (Strategy and Policies)*”, Prishtina, 2000; Collection of Papers, February 2001, pp. 119-133.
 - Një analizë e përmbledhur e gjendjes në sektorin e Telekomunikacionit në Kosovë, me theks në investimet që janë bërë dhe që duhen bërë për rehabilitimin e këtij sektori dhe për ngritjen e cilësisë së shërbimeve të tij.
16. **Nebi Caka**, “Leksiku poetik i Lasgush Poradecit”, *Seminari 19 ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, UP, Prishtinë, f. 543-551, 2001.
 - Gjuha e një shkrimtari mund të studiohet me anë të metodave të ndryshme. Njëra ndër to, pa mëdyshje jo dhe aq e rëndomtë, është metoda e analizës strukturale, e cila shfrytëzon edhe kompjuterin. Në këtë punim për një analizë të tillë është marrë poezia e Lasgush Poradecit. Në bazë të dendurisë së përdorimit të fjalëve në tekstin e poezisë të tij dhe të figurshmërisë së tyre, janë nxjerrë fjalët çelës dhe është bërë interpretimi i sistemit poetik që ato krijojnë.
17. **Nebi Caka**, “Disa aspekte të përgjithshme të hartimit të një fjalori të informatikës në gjuhën shqipe”, *Këshillimi “Çështje të terminologjisë së informatikës në gjuhën shqipe”* – ASHAK, Prishtinë, 14 dhjetor 2000.
 - Në këtë punim trajtohen çështjet aktuale të terminologjisë së informatikës në gjuhën shqipe dhe jepen parimet bazë për hartimin e një fjalori shpjegues anglisht-shqip nga lëmi i informatikës.
18. J. Kokaj, M. Marafie, Y. Makdisi, K. Bhatia, K. J. Mathew, **N. Caka**, R. Hasani, “A smart Ho-YAG laser lithotripter using optical correlation”, *Optical Pattern Recognition IX*, SPIE (The International Society for Optical

- Engineering), Vol. 3386, ISBN: 0-8194-2835-3, Paper nr. 3386-35, p. 301-310, 1998.
- Në këtë punim propozohet përdorimi i një litotriptori “të mençur” (*smart*) për thyerjen e gurëve në fshikëzën e tëmthit, bazuar në korrelacionin optik ndërmjet imazheve balistike dhe sinjaleve fluoreshente. Kjo do të minimizonte dëmtimin e indit të gjallë gjatë procesit të thyerjes së gurëve në fshikëzën e tëmthit, problem ky kryesor në litotripsinë laserike.
19. J. Kokaj, **N. Caka**, R. Hasani, “Një metodë e re në litotripsinë laserike”, *Kërkime* 5, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, fq. 87-96, Prishtinë, 1997.
- Në këtë punim propozohet një metodë e re optoelektronike për litotripsinë e gurëve në fshikëzën e tëmthit duke shfrytëzuar energjinë optike të laserit, por duke e shndërruar atë në plasje mekanike. Eksperimenti është realizuar në bazë të imazhimeve optoelektronike të përfuara me anë të mikroskopit dhe të sistemit optoelektronik për mikrofotografime. Fotografimi është realizuar duke e sinkronizuar kohën e ekspozimit me kohëzgjatjen e impulsit të laserit.
20. **Nebi Caka**, *Procjena kvalitete helikoidalnih magnetoskopa [The evaluation of helical video-tape recorder performance]* (Magistarski rad), Sveučilište u Zagrebu, Elektrotehnički Fakultet, Zagreb, 1988.
- Punim magjistrature. Në punim përkufizohen parametrat dhe metodat për përcaktimin e cilësisë së materialeve të regjistruara në magnetoskopët helikoidalë. Në bazë të matjeve të parametrave të përkufizuar, e sipas metodave të dhëna, jepet vlerësimi për cilësinë e këtyre magnetoskopëve. Matjet e parametrave të përkufizuar janë kryer në Televizionin e Prishtinës, tek firma AMPEX në Reading të Anglisë dhe Friburg të Zvicrës dhe tek firma SONY në Basingstoke të Anglisë. (116 faqe).
21. **Nebi Caka**, *Analizë statistike dhe stilistike e gjuhës së Lasgush Poradecit* (Punim magjistrature), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Prishtinë, 1985.
- Punim magjistrature në Fakultetin e Filologjisë. Në këtë punim, bazuar në metodat e sprovuara nga autoritetet në fushën e analizës statistike të teksteve poetike dhe të matematikës poetike, siç janë Myler, Markus, Giro etj. bëhet, për herë të parë, trajtimi i një teksti të një autori shqiptar. Gjatë përpunimit të tekstit është shfrytëzuar kompjuteri, dhe i tërë opusi poetik i Lasgushit është analizuar nga aspekti fonetik, morfologjik, metrik, semantik, etimologjik dhe figurativ, dhe në bazë të fjalëve çelës dhe të dendurisë së fonemave, emrave dhe peshës së figurativitetit (të njehsuar, sipas metodave të matematikës poetike) është bërë analiza stilistike e gjuhës së tij, dhe është paraqitur bota poetike e tij. (378 faqe).

4.2 Publikimet në gazeta

Dr. sc. Nebi Caka merret profesionalisht edhe me gjuhësi, sidomos me gjuhësinë strukturale, me leksikologjinë dhe me antroponiminë, e përveç kësaj është aktiv edhe si recensues, redaktor gjuhësor (lektor) dhe përkthyes nga anglishtja e serbokroatishtja i teksteve të ndryshme profesionale. Punimet nga gjuhësia kryesisht janë nga fusha e terminologjisë, leksikut dhe komunikimit, dhe merren me trajtimin e komunikimit njeri-njeri, pra dhe me aspekte të mësimdhënies, në përgjithësi.

1. **Nebi Caka**, “Huazimet leksikore dhe qëndrimi ndaj tyre”, *Koha ditore* Nr. 3339: *Koha për kulturë* Nr. 324, f. 29, Prishtinë, 30 shtator 2006.
2. **Nebi Caka**, “Kohët po ndryshojnë”, *Koha jonë*, Tiranë, 24 tetor 2006.
3. **Nebi Caka**, “Paragjykimet për shqiptarët dhe komunikimi me të tjerët”, *Koha ditore* Nr. 3297: *Koha për kulturë* Nr. 318, f. 29, Prishtinë, 19 gusht 2006.

4. **Nebi Caka**, “Metodologjitë e mësimimit elektronik”, *Mësuesi*, Tiranë, 5 korrik 2006.
5. **Nebi Caka**, “Sprovë për një fjalorth praktik Kosovë-Shqipëri”, *Koha ditore* Nr. 3186: *Koha për kulturë*, Nr. 302, f. 28, Prishtinë, 29 prill 2006.
6. **Nebi Caka**, “Çka korrigjon, e çka nuk korrigjon korrektori kompjuterik”, *Koha ditore: Koha për kulturë*, Nr. 253, f. 28, Prishtinë, 14 maj 2005.
7. **Nebi Caka**, “Standardizimi i terminologjisë së informatikës”, *Koha ditore: Koha për kulturë*, Nr. 231, f. 29, Prishtinë, 4 dhjetor 2004.
8. **Nebi Caka**, “Shqipërimi i disa termave të informatikës”, *Koha ditore: Koha për kulturë*, Nr. 220, f. 18, Prishtinë, 18 shtator 2004.
9. B. Bokshi, I. Ajeti, F. Raka, Sh. Islamaj, I. Bajçinca, F. Çitaku, **N. Caka**, “Akademia shpall orientimet për shqipen standarde”, *Koha ditore: Koha për kulturë*, Nr. 208, f. 27, Prishtinë, 26 qershor 2004.
10. **Nebi Caka**, “Si të bëhet fjalori shqip i informatikës”, *KOHA ditore: KOHA për kulturë*, nr. 31, 2000.

4.3 Tekstet e përkthyer

1. *Manual për BSCW (Basic Support for Cooperative Work), Versioni 4.2*, OrbiTeam Software GmbH and Fraunhofer FIT – Institute for Applied Information Technology, Germany, 2004. – Përktheu nga anglishtja: **Nebi Caka**.
2. *Korniza e kurrikulit të ri të Kosovës*, Departamenti i Arsimit dhe Shkencës, Prishtinë, 2001. – E përkthyer nga anglishtja: Gresa Sefaj dhe **Nebi Caka**.
3. B. Milojeviq, *Elektronika II*, Tekst për shkollat e mesme të elektroteknikës, Enti i teksteve mësimore, Prishtinë, 1974. – Përktheu nga serbokroatishtja: **Nebi Caka**.
4. F. Petroviq, *Bazat e teknikës së telekomunikacionit*, Tekst për shkollat e mesme të elektroteknikës, Enti i teksteve mësimore, Prishtinë, 1974. – Përktheu nga serbokroatishtja: **Nebi Caka**.
5. M. Petkoviq, *Elektronika*, Tekst për shkollat e mesme të elektroteknikës, Enti i teksteve mësimore, Prishtinë, 1974. – Përktheu nga serbokroatishtja: **Nebi Caka**.
6. J. Nikoliq, *Ngasjet elektrike*, Tekst për shkollat e mesme të elektroteknikës, Enti i teksteve mësimore, Prishtinë, 1974. – E përkthyer nga serbokroatishtja: **Nebi Caka** dhe Idriz Hasani.

4.4 Tekstet e redaktuara ose të recensuara

Nebi Caka, në harkun kohor 1974-2006, ka redaktuar/lekturuar më se 20 libra (disa mijëra faqe), të shkruara në shqip ose të përkthyer nga anglishtja në shqip, të botuara nga Universiteti i Prishtinës; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; KIPRED; GTZ, etj., prej të cilave po veçojmë:

1. Programi mësimor – Arsimi profesional: *Elektroteknikë*, Klasa 11, MASHT, Prishtinë, 2004. Lektorë: Safet Zejnullahu, Zenun Rexhepi, **Nebi Caka**.
2. Programi mësimor – Arsimi profesional: *Automekanik*, Shkalla I dhe II, MASHT dhe GTZ, Prishtinë, 2004. – Lektor: **Nebi Caka**.
3. Programi mësimor – Arsimi profesional: *Fermer*, Shkalla I dhe II, MASHT dhe GTZ, Prishtinë, 2004. – Lektor: **Nebi Caka**.
4. Programi mësimor – Arsimi profesional: *Instalues elektrik*, Shkalla I dhe II, MASHT dhe GTZ, Prishtinë, 2004. – Lektor: **Nebi Caka**.

5. Programi mësimor – Arsimi profesional: *Instalues ujësjellësi dhe kanalizimi*, Shkalla I dhe II, MASHT dhe GTZ, Prishtinë, 2004. – Lektor: **Nebi Caka**.
6. Programi mësimor – Arsimi profesional: *Metalpunues*, Shkalla I dhe II, MASHT dhe GTZ, Prishtinë, 2004. – Lektor: **Nebi Caka**.
7. Programi mësimor – Arsimi profesional: *Ndërtimtar*, Shkalla I dhe II, MASHT dhe GTZ, Prishtinë, 2004. – Lektor: **Nebi Caka**.
8. Programi mësimor – Arsimi profesional: *Rrobaqepës*, Shkalla I dhe II, MASHT dhe GTZ, Prishtinë, 2004. – Lektor: **Nebi Caka**.
9. Programi mësimor – Arsimi profesional: *Zdrukthëtar*, Shkalla I dhe II, MASHT dhe GTZ, Prishtinë, 2004. – Lektor: **Nebi Caka**.
10. Besnik Pula, *Shoqëria civile në tranzicion: Sektori i OJQ-ve në Kosovën e pasluftës*, KIPRED, Prishtinë 2004. – Lektor: **Nebi Caka**.
11. Konferenca Shkencore “*Zhvillimi i qëndrueshëm tekniko-teknologjik dhe mjedisi*” (Përmbledhje punimesh), ISBN 9951-85-14-0-1, Shoqata e inxhinierëve të Kosovës, Prishtinë, 2002. – Redaktorë: **Nebi Caka** dhe Musa Rizaj. – Redaktor gjuhësor: **Nebi Caka**.
12. Maija Könkkolä, Bujar Demjaha, *Problem apo sfidë? – Heqja e barrierave arkitektonike*, Finish Human Rights Project, Prishtinë, 2002. – Redaktor gjuhësor: **Nebi Caka**.
13. *...Informatori i studimeve 1999/2000* – Fakulteti i Elektroteknikës Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2000. – Redaktor përgjegjës: **Nebi Caka**.
14. A. Abazi, B. Sefa, L. Ahma, *Bazat e elektroteknikës 1*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 1999 – Lektor: **Nebi Caka**.
15. M. Hasanmetaj, *Bazat e programimit*, Nisma, Prishtinë, 1999 – Lektor: **Nebi Caka**.
16. M. Hasanmetaj, *Bazat e informatikës*, Nisma, Prishtinë, 1998 – Lektor: **Nebi Caka**.
17. Sh. Hasani, *Law dictionary (English-Albanien & Albanien-English)*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 1998 – Lektor: **Nebi Caka**.
18. Sh. Selimi, V. Sokoli, *Elektronika digjitale*, Libri shkollor, Prishtinë, 1998 – Recenzent: **Nebi Caka**.
19. G. Latifi, *Shndërrimi i energjisë*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 1997. – Lektor: **Nebi Caka**;
20. S. Limari, L. Ahma, *Elementet e sistemeve elektroenergjetike*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 1997 – Lektor: **Nebi Caka**.

4.5. Punimet profesionale

1. *Analiza e gjendjes aktuale, Analiza SWOT dhe Strategjia e planit zhvillimor të Sektorit të Shërbimeve me vlerë të lartë të shtuar (ShVLSH – HVAS)*, Strategjia dhe Plani Zhvillimor për Kosovën (SPZHK) 2007-2013, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, Zyra e Kryeministrit, Sekretariati i SPZHK-së dhe Instituti “Riinvest”, maj-tetor 2006 – koordinator i grupit të ekspertëve.
2. *Rishikim i projektit: Qendra transitore postare Fushë Kosovë, Projekti i instalimeve elektrike të teknologjisë së informacionit dhe telekomunikimeve, të sistemit të videombikëqyrjes dhe të alarmit kundër vjedhjes dhe kundër zjarrit*, Instituti i Teknologjisë, Report No.10 R.ED-01/2006, Prishtinë, 2006.
3. *Hartimi i kurrikulit (plan-programit) për Profilin “Teknik i mekatronikës”, klasa e 10-të për vitin shkollor 2006/2007*, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë, 2006.

4. *Hartimi i kurrikulit (plan-programit) për Shkollat Profesionale të Elektroteknikës për vitin shkollor 2006/2007* – koordinator i grupit të ekspertëve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë, 2006.
5. *Hartimi i kurrikulit (plan-programit) për Shkollat Profesionale të Elektroteknikës për vitin shkollor 2005/2006* – koordinator i grupit të ekspertëve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë, 2005.
6. *Hartimi i kurrikulit (plan-programit) për Shkollat Profesionale të Elektroteknikës për vitin shkollor 2004/2005* – koordinator i grupit të ekspertëve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë, 2004.
7. *Hartimi i strategjisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimeve të Kosovës 2005-2012* – anëtar i grupit të ekspertëve, Ministria e Telekomunikacionit, Prishtinë, 2004.
8. *Rishikim i projektit: Rehabilitimi i kullës së "Rilindjes", Projekti i instalimeve elektrike të teknologjisë së informacionit dhe telekomunikimeve, të sistemit të videobikëqyrjes dhe të alarmit kundër vjedhjes dhe kundër zjarrit*, Instituti i Teknologjisë, Report No. R.ED-01/2004, Prishtinë, 2004.
9. *Hartimi i kurrikulit (plan-programit) për Shkollat Profesionale të Elektroteknikës për vitin shkollor 2003/2004* – koordinator i grupit të ekspertëve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë, 2003.
10. *Projekti i gjendjes së Sektorit të Telekomunikimeve në Kosovë (Project on the Situation of Telecommunications Sector in Kosova*, janar-mars 2000, financuar nga Instituti "Rinvest", Prishtinë.
11. *Projekti i vlerësimit të dëmeve në objektet e Universitetit të Prishtinës (Project on the assessment of damages in the premises of Prishtina University)*, shtator 1999), financuar nga Universiteti i Prishtinës, – koordinator i grupit të ekspertëve.
12. *Projekte të audioinstalimeve dhe videoinstalimeve në Televizionin e Prishtinës (RTP)*, (1973-1990), financuar nga Televizioni i Prishtinës.
13. *Projekte të instalimeve elektrike dhe të telefonisë në shtëpi individuale dhe në ndërmarrje private* (1990-2003), financuar nga pronarët e shtëpive individuale dhe pronarët e ndërmarrje private.

4.6 Dispensa dhe libra

1. **Nebi Caka**, Agni Dika, Seb Rodiqi, *Fjalor i informatikës anglisht-shqip, shqip-anglisht; Dictionary of Informatics English-Albanian, Albanian-English*, Redaktor: Rexhep Ismajli, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës [Kosova Academy of Sciences and Arts], Prishtinë, 2005.
 - Në kohën kur informatika është bërë shumë e rëndësishme për çdo veprimtari të organizuar shoqërore, terminologjia e kësaj fushe zë një vend me rëndësi në leksikun e gjithëmbarshtëm të një gjuhe dhe sidomos në përdorimet e përditshme, ndaj dhe rëndësia e fjalorëve të këtij lloji. Ky fjalor i informatikës, i pari i llojit të vet, përmban rreth 18000 terma e shkurtesa, anglisht e shqip kryesisht nga *shkencat kompjuterike, inxhinieria kompjuterike, inxhinieria e softuerit dhe teknologjia e informacionit*, por edhe mjaft fjalë nga shkencat e inxhinieritë e tjera, si: matematika, fizika, logjika, linguistika, teoria e informacionit; telekomunikacionet, elektronika me mikroelektronika e optoelektronikë, automatika etj., që janë të lidhura ngushtë me informatikën. Në të është dhënë edhe një numër i konsideruar frazeologjizmash që përdoren në këtë fushë, para se gjithash në Internet, por dhe një numër i caktuar fjalësh të përdorimit të përgjithshëm, këto të fundit për t'i lehtësuar lexuesit të kuptuarit të fjalëve që nuk janë përfshirë në këtë fjalor e që mund t'i hasë në jetë (502 faqe).

2. **Nebi Caka**, Zija Bylykbashi, *Në udhëkryqe të jetës – Brezi 1963-1964 i gjimnazistëve të Gjimnazit “Sami Frashëri” të Prishtinës – 40 vjet pas*, Monografi, Gjimnazi “Sami Frashëri”, Prishtinë, 2005.
 - Një monografi e cila mëton të jetë një kontribut për historikun e Gjimnazit “Sami Frashëri” të Prishtinës. Ajo paraqet rrugën jetësore të maturantëve të brezit 1963/64. Për ta bërë më të përfytyrueshme kohën dhe rrethanat në të cilat u shkollua ky brez, autorët në këtë monografi kanë përfshirë edhe disa të dhëna faktografike, të marra nga shtypi i kohës, nga Interneti ose nga burime të tjera të besueshme, të cilat i ilustronë rrethanat politike, sociale e kulturore të kohës në të cilën u shkollua ky brez, por dhe të periudhës që pasoi. Librit i paraprin një historik i shkurtër i këtij Gjimnazi, i shkruar nga Abdyl Gashi dhe Nebi Caka. Në fund të librit jepet treguesi i emrave – personave (më se 1000) që përmenden në monografi, literatura e shfrytëzuar dhe numrat e telefonave dhe e-mailat e ish-maturantëve të gjallë. (234 faqe)
3. **Nebi Caka**, *Mikroelektronika*, Fakulteti i Elektroteknikës, Prishtinë, 2006.
 - Dispensë hartuar sipas plan-programit të kësaj lënde për studentët e Fakultetit të Elektroteknikës në Prishtinë. Është e strukturuar në 8 kapituj. Përfshin teknologjinë e fabrikimit të qarqeve të integruara monolite dhe hibride, parimet kryesore të projektimit të qarqeve të integruara, si dhe qarqet elementare analoge dhe digjitale, kryesisht nga aspekti i fabrikimit të tyre. Janë trajtuar detajisht edhe komponentet (elementet) kryesore të qarqeve të integruara, si: transistorët (bipolarë dhe unipolarë MOSFET), diodat, rezistorët e kondensatorët Jepen edhe shembuj problemesh (detyrash) të zgjidhura, si dhe literatura përkatëse e shfrytëzuar për hartimin e kësaj dispence. Është në përgatitje të botohet si tekst universitar. (rreth 300 faqe).
4. Jahja Kokaj, **Nebi Caka**, *Laserët – Parimet dhe zbatimet*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2001.
 - Tekst universitar, i hartuar sipas plan-programit të kësaj lënde për studentët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Prishtinë, e që mund të përdoret edhe nga studentët e tjerë që dëgjojnë kursin nga Laserët. Ka gjashtë kapituj, në të cilët, krahas parimeve themelore të punës së laserëve, jepen edhe llojet kryesore të laserëve dhe zbatimet e tyre, si në: metrologji, mjekësi, holografi e telekomunikacion. Një nënkapitull i kushtohet mbrojtjes nga drita e laserit. Pas çdo kapitulli jepet bibliografia përkatëse, e në fund Treguesi i lëndës dhe Biografite e autorëve. (314 faqe)
5. **Nebi Caka**, *Bazat e Elektronikës*, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 1999.
 - Dispensë hartuar sipas plan-programit të kësaj lënde për studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në Tetovë. Përfshin bazat teorike të elektronikës, si dhe elementet kryesore të qarqeve elektronike (diodat, transistorët) dhe qarqet elementare elektronike (rrymëdrejtuesit, amplifikatorët etj.). Përmban edhe shembuj detyrash të zgjidhura nga lënda që trajtohet në të.
6. **Nebi Caka**, *Optoelektronika*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 1996.
 - Tekst universitar, i hartuar sipas plan-programit të kësaj lënde për studentët e Fakultetit të Elektroteknikës në Prishtinë, e duke konsultuar një literaturë të gjerë nga ky lëmë (e cila citohet në fund të çdo kapitulli). Libri përmban gjashtë kapituj, në të cilët jepen bazat fizike të optoelektronikës dhe trajtohen elementet dhe sistemet kryesore optoelektronike, si: fotoemiterët (LED-at) e fotodektorët (fotodiodat e fototransistorët), laserët (e llojeve të ndryshme), modulatorët optikë, sensorët optikë, disqet optike; sistemet e komunikimeve me fije optike, sistemet e përpunimit optikë, holografia, kompjuteri optik etj. Pas çdo kapitulli jepet një numër i caktuar problemesh, që duhen zgjidhur. Libri në fund ka Treguesin e emrave dhe Treguesin e lëndës. (514 faqe).

5. Vlerësimi dhe mendimi

Nga të dhënat biografike, veprimtaria shkencore, profesionale dhe pedagogjike, Komisioni konstaton se kandidati

- është i dalluar si profesionist me përvojë shumëvjeçare në sistemet audio dhe video të teknikës televizive, e së voni edhe në sistemet satelitore
- ka përvojë të gjatë të punës së suksesshme në universitet,
- ka hartuar tri tekste universitare nga lëmi në të cilin konkurren,
- merret me hulumtimin e problemeve shkencore me aktualitet ndërkombëtar dhe ka një numër punimesh shkencore të publikuara me rezultate relevante nga lëmi në të cilin konkurren,
- merret me hartimin e plan-programeve mësimore,
- kultivon relacione shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi me kolegë dhe studentë.

6. Propozim për thirrje (titull)

Në bazë të asaj që u theksua më lart, dhe duke pasur parasysh të gjitha kushtet e nevojshme të parapara me dispozitat përkatëse të neneve 180-187 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Komisioni ka nderin që Këshillit Shkencor të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike t'i propozojë që **Dr.sc. Nebi Cakën** ta zgjedhë në thirrjen (titullin) **Profesor i asocuar** për lëndët “*Mikroelektronikë*” dhe “*Optoelektronikë*”.

Në Prishtinë, më 06.01.2007

Komisioni:

1. Dr. sc. Myzafere Limani, prof. asc. – kryetar

2. Dr. sc. Jahja Kokaj, prof. ord – anëtar

3. Dr. sc. Abdurrahman Grapci, prof. ord – anëtar
